



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 14.4.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Hestet Cakolli, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina, Dragiša Mirić,  
Munguan : Selvie Halimi (pushim), Zulfi Merxha, Lulzim Zeneli (ka arsyetuar mungesën).

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MMPH-Ministri Mahir Yagcillar dhe zyrtarët Remzush Latifi, Enver Tahiri, Drejtori i ZRRUM-Afrim Lajçi dhe Kryetari i Këshillit për Ujëra-Ali Shala , nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Institucionet e pavarura që raportojnë Kuvendit të Kosovës,
3. Monitorimi i Ligjit për Mbeturina.

**Kryesuesi Naim Maloku** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar** (u shty për më vonë për shkak të mungesës momentale të kuorumit)

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Institucionet e pavarura që raportojnë Kuvendit të Kosovës**

**Naim Maloku** përshëndeti ministrin Yagcillar dhe zyrtarët tjerë të ftuar të cilët edhe një herë shkurtimisht i njoftoi për shkakun e ftesës për këtë mbledhje ku duhet të sqarohen faktet rreth funksionimit të organeve të pavarura (a janë themeluar, a funksionojnë, si bashkëpunojnë me MMPH, çfarë buxheti kanë etj), kërkesë kjo nga Kryesia e Kuvendit.

**Mahir Yagcillar** falënderoj për bashkëpunimin e vazhdueshëm të komisionit sidomos në sferën e ujërave ku sipas mendimit të tij duhet bashkërisht të tejkalohen problemet. Ai tha se me ZRRUM-Rregullatorin- ka pasur takime, ndërkaq për mosfunksionimin e Këshillit të

Ujërave nuk kishte shpjegime ngase është themeluar në mandatin e kaluar, por ekziston nevoja e implementimit të ligjit.

**Ali Shala** kryesues i Këshillit për Ujëra, tha se prej themelimit të Këshillit të Ujërave dy herë ka kontaktuar me ish drejtoreshën e departamentit të ujërave e cila është përgjegjës se ajo do të ftoj Këshillin për takime, por asgjë deri tani, dmth kjo është arsyeja e vetme pse nuk ka punuar deri tani Këshilli, arsyeji tjera nuk ka. Ai ishte i mendimit se gjendja është alarmante sa i përket ujërave, prandaj duhet të veprohet shpejt.

**Naim Maloku** në cilësinë e kryesuesit tërhoqi vërejtjen kreut të këtij organi të pavarur (Këshillit) dhe MMPH se kemi të bëjmë me ballafaqimin e tyre me një organ shtetëror, madje kryesorë-Kuvendin e një shteti, ndaj në punën e mëtejme ose duhet të veprohet si shtet ose të mosfunksionojnë fare organet. Ai citoi pikë për pikë nenin 17 të Ligjit për Ujëra me të cilin themelohet ky këshillë, ndaj pyeti ku janë shkaqet për mospunë dhe nëse nuk ka ndonjë të vërtet tjetër kërkoi sugjerime si të veprohet më tutje.

**Berat Luzha** kërkoi nga mysafiri sqarime për mosfunksionim ose mosveprim e jo shpjegime rreth rëndësisë së ujërave, ngase deri tani është dashur të sjellën raportet.

**Afrim Lajçi-drejtor** sa i përket Rregullatorit (ZRRUM) njoftoi shkurtimisht për themelimin dhe funksionimin e tij nën ombrellën e UNMIK-ut (PSSP) deri në vitin 2008, kur kompetencat janë përcjellë institucioneve vendore-Kuvendit të Kosovës. Ai njoftoi komisionin se ky organ ka dërguar raportin për Kuvend më 31 mars 2009 por nuk kishte njohuri a janë njoftuar zyrtarët e komisionit. Kjo zyre ka punuar në bazë të një ligji tjetër e jo në bazë të Ligjit për Ujëra (përmirësoi folësit e mëparshëm).

**Naim Maloku** tha se raportin ende nuk e ka marr Kuvendi – anëtarët e komisionit, me siguri për shkaqe teknike, por konstatoi se ZRRUM me këtë njoftim e ka kryer obligimin e sqarimeve, ndërkaq në mbledhjet tjera të komisionit do të shqyrtohet raporti i dërguar dhe poçes është nevoja do të ftohet përfaqësuesi për sqarime shtesë.

**Dragisha Miriç** pyeti kryetarin Shala a ka përdor njoftimin me shkrim në komunikimin me zyrtaren e departamentit për ujëra dhe pse nuk ka bërë një gjë të tillë.

**Naim Maloku** dhe **Berat Luzha** kishin deklarata kundërtënëse, z. Maloku tha se duhet një afat shtesë për funksionalizim, ndërsa z. Luzha tha se duhet të raportoj Këshilli, mirëpo ishte konstatimi jokontestues se Këshilli ende nuk ka mbajtur mbledhjen konstituive.

**Zef Morina** konstatoi se me ZRRUM është çdo gjë në rregull por pyeti ministrin pse nuk është zbatuar pika 17.8 i nenit 17 të Ligjit për Ujëra (Këshilli mbështetet nga staf civil i MMPH).

Ministri **Yagcillar** ripërsëriti se kjo ministri është interesuar për funksionimin e Këshillit por çka ka ndodhur nuk kishte shpjegime (me siguri me aludim se çka ka ndodhur në mandatin e kaluar).

**Naim Maloku** lexoi shkresën e ish kryetarit të këtij komisionit Rifat Krasniq që ka përshëndetur formimin e këtij Këshilli në mandatin e kaluar më 4.6.2007, kur ky Këshill është përshëndet nga ky komision dhe është përcjellë në departamentin e ujërave të MMPH për punën e mëtejme me një mandat 5 vjeçar, ndaj propozoi, ndërsa komisioni miratoi këtë :

## P Ë R F U N D I M

**MMPH të kontaktoi me anëtarët e Këshillit të Ujërave të Kosovës me qëllim të funksionalitetit të tij në afatin dy javorë, ndërkaq nëse ka nevojë për riemërim, MMPH ti drejtoj Kuvendit propozimin me shkrim.**

Pasi që Kryesia e Kuvendit duhet të njoftohet për organet e pavarura, **Naim Maloku** propozoi dhe komisioni miratoi këtë :

## K O N K L U D I M

**Kryesia e Kuvendit të njoftohet si vijon :**

1. **ZRRUM-Rregulatori**- është duke funksionuar sipas Ligjit në fuqi nr.03/L-086, ndërkaq raporti i dërguar për Kuvendin e Kosovës nga kjo zyre i dt. 31 mars 2009 do të shqyrtohet në komision dhe Kuvendit do ti dërgohet rekomandimi për miratimin e tij.
2. **Këshilli i Kosovës për Ujëra** deri tani nuk ka funksionuar fare, ndaj i epet afati prej dy javësh për funksionalizim.

### 3. Monitorimi i Ligjit për Mbeturina

**Naim Maloku** në fillim ia dha fjalën përfaqësuesit të ZRRUM **Afrim Lajçit** drejtor, i cili shprehu interesimin për monitorimin e Ligjit për Mbeturina për çka komisioni premtoi se do të njoftohet rregullisht, poashtu edhe do të ftohet për kontribut, ndërkaq në vazhdim **Blerim Vela** njoftoi komisionin me propozim planin për fazat e monitorimit të këtij ligji. Në këtë kuadër, i propozoi Komisionit Parlamentar të shqyrtoj zbatimin e ligjit në pikat vijuese:

- I. Sa janë përmbushur qëllimet e ligjit? Si është gjendja në terren?
- II. A janë përgatitur dhe a po zbatohen dokumentet e planifikimit për administrimin e mbeturinave?
- III. Sa janë funksionale autoritetet për administrimin e mbeturinave? A bëhet mbikëqyrja administrative dhe inspektuese?
- IV. A janë duke i përmbushur përgjegjësitë dhe detyrimet për administrimin e mbeturinave prodhuesit dhe importuesit e mallrave, prodhuesit e mbeturinave, transportuesit e mbeturinave, operatorët për trajtimin e mbeturinave, operatorët në deponi?
- V. A janë marrë masat e duhura për realizimin e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave?
- VI. A ka pasur raste të qarkullimit ndërkufitar të mbeturinave? Nëse po, si janë trajtuar këto raste?
- VII. A është përgatitur raporti dhe regjistri i të dhënave për administrimin e mbeturinave?
- VIII. Sa raste të shkeljes së dispozitave të ligjit janë regjistruar? Çfarë dënime janë shqiptuar?
- IX. A janë përgatitur të gjitha aktet nënligjore sipas afatit të paraparë në ligj?

**Naim Maloku** përshëndeti punën e zyrtarëve nga OSCE për këtë plan por te paraqitja tabelare nën pesë (V) propozoi të mos mbahet në prill por drejtpërdrejt ti dërgohet Divizionit për Zyrën Ligjore të MMPH, faza e dytë të mbahet bashkë me MMPH dhe ZRRUM (java e parë e majit), ndërsa faza e III të filloi në pjesën e dytë të muajit maj dhe të vazhdoi në pjesën e parë të qershorit, ndërkaq faza e V (hartimi i raportit) në fund të qershorit, dmth si vijon :

- **Faza e parë**, të merren informacionet e para zyrtare nga institucionet qeveritare, komunale etj.
- **Faza e dytë** të organizohet dëgjimi parlamentar me MMPH dhe ZRRUM, ku anëtarët e Komisionit mund të adresojnë çështje specifike që lidhen me zbatueshmërin e ligjit.
- **Faza e tretë**, sipas përcaktimit të Komisionit, vizitohen pesë komuna, me zyrtarët kompetentë,
- **Faza e katërt**, një formë e dëgjimit publik me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, ku Komisioni do të mund të fokusohet në hartimin e rekomandimeve për raportin e zbatimit të ligjit për mbeturinat.
- **Faza e pestë**, përgatitja e raportit të monitorimit për zbatimin të ligjit për mbeturinat.

Pasi që edhe **Zef Morina**, **Heset Cakolli** mbështetën propozimet e **Blerim Velës** dhe **Naim Malokut**, komisioni nxori :

## **P Ë R F U N D I M**

**MIRATOHET** plani i këtij Komisioni për monitorimin e Ligjit për Mbeturina me pyetësorin e propozuar nga zyrtarët e OSCE dhe me përmirësimet e nënkryetarit të Komisionit.

**OBLIGOHET** Ministria e Mjedisit-Divizioni për menaxhimin e Mbeturinave, të jap mbështetje duke përgatitur të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore sa i përket çështjes së mbeturinave, dhe deri 28 prill 2009 të dërgoi raportin lidhur me këtë plan, në mënyrë që komisioni me 1 maj të ketë të gatshëm raportin me shkrim në komision për diskutim, kur komisioni do të vendos për veprime të mëtejme lidhur me monitorimin e këtij Ligji.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet brenda dy javësh.

Kryesuesi i Komisionit,  
**Naim Maloku**